



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 202, date 10.4.2019

PËR

**PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR LËSHIMIN E DOKUMENTEVE LIGJORE PËR
TRANSFERIMIN NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE USHTARAKE DHE TË
ARTIKUJVE E TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË DYFISHTË, QË LËSHOHEN
NGA AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumenteve ligjore për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 341, datë 8.4.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumenteve ligjore nga Autoriteti I Kontrollit Shtetëror të Eksporteve subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1.

Tarifat për lëshimin e dokumenteve ligjore për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

SHËRBIMI	TARIFA NË LEKË
1. Licencë individuale eksporti për mallra ushtarake.	3000
2. Licencë individuale për eksport të përkohshëm për mallrat ushtarake.	3000
3. Licencë individuale për riekспорт për mallra ushtarake.	3000
4. Licencë individuale importi për mallra ushtarake.	3000
5. Licencë individuale për import të përkohshëm për mallrat ushtarake.	3000
6. Licencë individuale për transit ndërkombëtar të mallrave ushtarake.	3000
7. Licencë individuale për transship ndërkombëtar të mallrave ushtarake.	3000
8. Licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese (brokerage) për mallrat ushtarake.	3000
9. Autorizim për negociim të marrëveshjeve ndërkombëtare për mallra ushtarake për vendet nën embargo.	3000
10. Certifikatë e regjistrimit për mallrat ushtarake.	3000
11. Certifikatë ndërkombëtare importi për mallra ushtarake.	3000
12. Certifikatë e përdoruesit të fundit për	3000

mallra ushtarake.	
13. Certifikatë e mbërritjes së mallit në destinacion (DVC) për mallra ushtarake.	3000
14. Licencë individuale eksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.	3000
15. Licencë globale eksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.	3000
16. Licencë individuale për eksport të përkohshëm për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.	3000
17. Licencë individuale për riekспорт për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.	3000
18. Licencë individuale importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.	3000
19. Licencë globale importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.	3000
20. Licencë individuale për import të përkohshëm për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.	3000
21. Licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese(brokerage) për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.	3000
22. Licencë individuale për transferim softëare ose teknologjive nëpërmjet rrugëve elektronike.	3000
23. Licencë individuale për transit ndërkombëtar të artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.	3000
24. Licencë individuale për transship ndërkombëtar të artikujve dhe teknologjive	3000

me përdorim të dyfishtë.	
25. Licencë individuale për mallrat që nuk përfshihen në listën e miratuar për kontroll.	3000
26. Autorizim për negocim të marrëveshjeve ndërkombëtare për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.	3000
27. Certifikatë ndërkombëtare importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.	3000
28. Certifikatë e përdoruesit të fundit për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3000
29. Certifikatë e mbërritjes së mallit në destinacion (DVC) për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.	3000
30. Lëshim dublikate i licencës/certifikatës/autorizimit të dhënë.	1000